



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primjenol/Prodato Received/Deliverty	23.06.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTUK	4900/2023		115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.721/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Kaltrina Avdullahi-Prenaj Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.721/2023 të datës 11.05.2023, të parashtruar nga ankuesi me adresë: kundër Vendimit me numër Nr.1-111/01-22203 të datës 02.05.2023 të Zyrës së Personelit të Komunën e Lipjanit, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 23.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.721/2023 e datës 11 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Nr.1-111/01-22203 i Zyrës së Personelit të Komunës së Lipjanit.

A r s y e t i m

Komuna e Lipjanit duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 si dhe nenin 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht më datë 16.03.2023 ka njoftuar lidhur me konkursin numër të referencës Nr. RN00011227, ndërsa më datë 06.04.2023 ka shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale lidhur me pozitën e punës "Zyrtar për Shërbime Sociale 2".

Në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Kryetari i Komunës së Lipjanit më datë 10.05.2023 ka nxjerr Vendimin me numër nr.1-020/04-23850 për Formimin e Komisionit për Pranim në Shërbimin Civil, për pozitën për emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale-Zyrtarë për Shërbime Sociale 2.

Udhëheqësja e Personelit në Komunën e Lipjanit më datë 02.05.2023 ka nxjerr Vendimin me numër Nr.1-111/01-22203, sipas të cilit ankuesi është njoftuar se nuk është përfshirë në listën e ngushtë në konkursin për grupin Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale për pozitën e punës Zyrtar për Shërbime Sociale 2, me arsyetimin se me rastin e aplikimit nuk e ka bashkangjitur vërtetimin e përvojës së punës, ndërsa i njëjti në SIMBNJ ka bashkangjitur vetëm Llogarinë nga Trusti Pensional i Kosovës.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me numër me numër Nr.1-020/04-23850 të datës 02.05.2023 të Njesisë së Personelit të Komunës së Lipjanit, ka parashtruar ankesë në Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit, ndërsa më datë 10.05.2023 Udhëheqësja e Personelit përmes përgjigjes në ankesë me numër 01 Nr.111/01-23959 e ka njoftuar ankuesin se ankesa e tij është refuzuar, pasi që i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit.

Më datë 11.05.2023 ankuesi, përmes e-mailit zyrtar, ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 4181/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimin me numër Nr.1-020/04-23850 të datës 02.05.2023 të nxjerrë nga Udhëheqësja e Personelit në Komunën e Lipjanit, me pretendimin ankimor për refuzimin e aplikacionit gjatë fazës së shqyrtimit fillesatar të aplikimit në konkursin me numër të referencës RN00011227 të datës 16.04.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.06.2023 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë të Komuna e Lipjanit. Ndërsa Këshilli me po të njëjtën datë ka pranuar përgjigje në ankesë me të gjitha shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesa me numër protokollit 4181/2023 e datës 11.05.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesë nga Përgjigje në ankesë me numër 01 Nr.111/01-23959 e datës 10.05.2023; Konkurs i jashtëm me numër reference Nr.RN00011227 i datës 06.04.2023; Vendim me numër Nr.1-111/01-22203 i datës 02.05.2023; E-mail i datës 14.06.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 13.06.2023; përgjigje në ankesë e 13.06.2023; Lista e aplikantëve me numër reference RN00011227; Vendim me numër Nr.1-020/04-23850 i datës 10.05.2023; Akt Emërimi i i datës 22.07.2013; Akt Emërimi me numër Nr.1-112-37766/2021 i i datës 09.07.2023; Akt Emërimi me numër Nr.01-112/01-4622/2023 i XH.I.M i datës 20.01.2023; Akt Emërimi i i datës 05.11.2013; Kontratë Pune; Aplikacion i datës 16.04.2023; Diplomë e datës 10.06.2023; Diplomë e datës 28.05.2023; Diplomë e studimeve Master; Diplomë e datës 26.06.2023; Certifikatë e datës 14.04.2023; Certifikatë e datës 26.11.2023; Certifikatë e datës 09.12.2023; Certifikatë tetorë 2021; Certifikatë e datës 12.02.2023; Certifikatë e datës 05.07.2020; Certifikatë 15.08.2020; Trusti periudha 01.08.2002-10.03.2023; Certifikatë e datës 14.11.2007; Certifikatë e datës 08.04.2023; Certifikatë 07.04.2023; Certifikatë e datës 05.04.2023; Certifikatë e datës 06.04.2023; Letërnjoftim për Certifikatë mbi denimet penale e datës 14.04.2023; Aplikacion i i

datës 07.04.2023; Diplomë e datës 01.07.2015; Diplomë e datës 07.10.2019; Certifikatë; Certifikatë e datës 03.12.2018; Certifikatë; Certifikatë tetor 2021; Certifikatë; Certifikatë; Vërtetim i datës 24.05.2018; Vërtetim mbi praktikën i datës 10.06.2019; Vërtetim me numër Nr.3-113-8032 i datës 15.03.2022; Trusti i datës 12.06.2022; Kontratë e vullnetarit e datës 24.04.2021; Shkresë e datës 27.04.2021; Vërtetim i datës 01.11.2022; Referencë e datës 26.09.2022; Letërnjoftim i Certifikatë mbi denimet penale e datës 06.04.2023; Njoftim me numër protokoll 1-111/01-27281.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit për emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale kanë qenë:

- *Diplomë e arsimit të lartë më së paku tre (3) vite të studimeve. Fakulteti i Psikologjisë, Punë Sociale, Sociologjisë dhe Juridik;*
- *Kualifikime të Posaçme formale; si dhe*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, Kolegji pas analizimit të dosjes së aplikimit të ankuesit dhe organit të punësimit ka gjetur se ankuesi me rastin e aplikimit për këtë pozitë si dëshmi të kualifikimit shkollor dhe përgatitjes së përvojës së punës posedon: Diplomë Universitare me numër Nr.643 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës më datë 28.05.2008 me të cilën dëshmohet se ankuesi e ka kryer Fakultetin e Sociologjisë më datë 25.02.2008 dhe mori titullin "Bachelor i Sociologjisë" si dhe Pasqyrën e Llogarisë së Trustit Pensional të Kosovës prej periudhës 01.08.2002 deri më 10.03.2023, rrjedhimisht ndërlidhur me përvojën e punës Kolegji ka konstatuar se i njëjti me rastin e aplikimit për pozitën e lartëcekur, në aplikacion ka shënuar përvojat e punës mirepo si dëshmi për përvojën e punës ankuesi ka dorëzuar vetëm Pasqyrën e Trustit Pensional ndersa nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi kontrate të punës apo vërtetim punësimi nga institucioni përkatës, me të cilat dëshmohet saktë periudha e përvojës së punës, pozita të cilën e ka mbajtur dhe për çfarë periudhe kohore ka punuar në atë pozitë, kohëzgjatja në pozitën e caktuar dhe arsyet e shkëputjes së marrëdhënies së punës nga ajo pozitë, gjë që për Kolegjin ka qenë e pamundur të vërtetoj periudhën kohore të punës së ankuesit lidhur me pozitën të cilat i ka mbajtur tek institucionet përkatëse dhe periudhën kohore se sa ka punuar, e krejt kjo në kundërshtim me dispozitën ligjore në fuqi. Prandaj pas konstatimit të këtyre fakteve, Kolegji vlerëson se ankuesi bazuar në dëshmitë të cilat i ka paraqitur me rastin e aplikimit nuk ka arritur të dëshmojë përvojën e punës prej 1(një) viti përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës", ashtu siç është kërkuar me konkurs.

Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit, bazuar në kriteret e konkursit po ashtu edhe dëshmitë e bashkangjitura nga ankuesi, në pajtim me nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka bërë vlerësimin paraprak nëse kandidatët kanë plotësuar kushtet e konkursit, rrjedhimisht në bazë të kësaj ankuesi me Vendimin me numër Nr.1-111/01-22203 të datës 02.05.2023 është njoftuar që nuk ka plotësuar kushtet e konkursit me arsyetimin se i njëjti nuk e ka bashkangjitur Vërtetimin e përvojës së punës ndërsa ka bashkangjitur vetëm Llogarinë e Trustit Pensional. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në bazë të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, janë përcaktuar kriteret për secilën kategori të shërbimit civil, konkretisht pozita për emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale 2, hyn në kategorinë e nivelit profesional 2, ku shtojca me numër Nr. 1/7 pika IV e kësaj rregulloreje tek kërkesat e përgjithshme formale- përvoja e punës theksohet se. *“Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1(një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës”*, e në këtë rast meqenëse ankuesi, nuk ka ofruar dëshmi (vërtetim, kontrate të punës apo referencë) lidhur me përvojën e punës në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës siç kërkohet në konkurs por ka bashkangjitur vetëm Pasqyrën e Llogarisë së Trustit Pensional, atëherë sipas normave ligjore i njëjti nuk i ka plotësuar kushtet e përcaktuara të konkursit, rrjedhimisht Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Lipjanit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër me Vendimin me numër Nr.1-111/01-22203 të datës 02.05.2023 për mos përfshirje në listën shkurtër të ankuesit ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me nenin 15 paragrafi 1, 2, dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *“Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak..5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin”* ndërlidhur me nenin 34 paragrafi 6 nen paragrafi 6.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe shtojcën me numër Nr. 1/7 pika IV, e të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Andaj mbi këtë mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit që i njëjti i ka plotësuar kushtet e konkursit sa i përket përvojës së punës është i pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Zyra e Personelit të Komunës së Lipjanit Vendimin me numër Nr.1-111/01-22203 të datës 02.05.2023 e ka nxjerrë në përputhje me nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 47 , 48 dhe 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe juridike.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër Vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.721/2023

Kaltrina Aydullahi-Prenaj


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Lipjanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

